



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:105151

Datë: 25.05.2021

Numri i dokumentit: 01813543

C.nr.485/18

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Kaltrinë Haliti, në çështjen juridike të paditëses V. M nga Gjilani, me përfaqësuesen ligjore Violeta Sadiku, të cilën e përfaqëson me autorizim Ardian Klaiqi, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material dhe jo material, pas mbajtjes së seancës mbi shqyrtimin kryesor të datës 24.05.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditëses V. M nga Gjilani, e ushtruar kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, dhe **DETYROHET** e paditura që paditëses, pjesërisht t’ia kompensojë dëmin material dhe jo material të shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit më datë 29.11.2015, edhe atë:

- Për paditësen Vlera Matoshi për dëmin jo material:

- Për dhembje trupore fizike, shumën e të hollave në lartësi prej 3500€.
- Për frikën e shkaktuar, shumën e të hollave prej 2000€
- Për dhimbjet shpirtërore për shëmtimin trupor shumën prej 1500€
- Për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën e të hollave prej 2000€

Të gjitha këto për dëmin jo material në shumë prej 9000 € (nëntë mijë euro) me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, respektivisht nga data 24.05.2021 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET si pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses V. M nga Gjilani, në lartësi prej 7000 € (shtatë mijë euro), në emër të dëmit jo material e kërkuar më shumë se shumat e gjykuara.

III. DETYROHET e paditura që paditëses, pjesërisht t’ia kompensojë dëmin material të shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit më datë 29.11.2015:

Për dëmin material edhe atë:

- Për shpenzimet e mjekimit 40.10€.
- Për ndihmën e personit të tretë 300€.
- Për ushqim të përforcuar 300 €.

Të gjitha këto për dëmin material në shumë në shumë prej 640.10 € (gjashqindë e katërdhjetë euro e dhjetë cent) me kamatë bankare ashtu siç paguajnë bankat komerciale në Kosovë për mjetet e deponuara pa destinim të veçantë, që nga data 29.11.2015 si ditë e shkaktimit të dëmit, kurse pas kësaj date me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke llogaritur nga data e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, konform nenit 382 paragrafi 2 të LMD-ës, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

IV. REFUZOHET si pabazuar pjesa tjetër e kërkesë padisë në emër të përkuqdesjes së personit të tretë dhe për ushqim të përforcuar të paditëses V. M nga Gjilani, shuma në lartësi prej 3400€ (temijë e katërqindë euro) në emër të dëmit material e kërkuar më shumë se shumat e gjykuara si dhe shuma në lartësi prej 464.42€ në emër të shpenzimeve të mjekimit.

V. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesa e paditëses V.M nga Gjilani, sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, dhe **OBLIGOHET** e paditura Kompania e Sigurimeve „Siguria,, me seli në Prishtinë, që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës edhe atë shumën në lartësi prej 715€ (shtatëqindë e pesëmbëdhjetë euro) në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm, ndërsa **REFUZOHET** si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesës së paditëses për pagesën e shpenzimeve të kërkuara, edhe atë shuma në lartësi prej 791€

A r s y e t i m

Paditësja, përmes përfaqësuesit të saj me autorizim si në shkresat e lëndës në këtë gjykatë ka ushtruar padi¹ për kompenzimin e dëmit material dhe jomaterial kundër të paditurës dhe me precizimin e kërkesëpadisë së datës 24.05.2021, ka kërkuar që të aprovohet kërkesepadia e paditëses vlera Matoshi nga Gjilani në tërësi si e bazuar dhe të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve ”Siguria”, me seli në Prishtinë që paditëses në emër të shpërblimit të dëmit material dhe jomaterial të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 29.11.2015, të ia paguajë shumat edhe atë për dëmin jomaterial: për dhimbjet trupore fizike shumën prej 5000€, për frikën e shkatuar shumën prej 3000€, për dhimbjet shpirtërore për shëmtim trupor shumën prej 5000€, për zvoglim të aktiviteti jetosor shumën prej 3000€ dhe për dëmin material: për ndihmën dhe kujdesin e huaj shumën prej 2000€, për ushqim të sforcurar shumën prej 2000€, për shpenzimet e mjekimit shumën prej 40.10€, gjithsej shumën prej 20,040.10€² për të gjitha format e dëmit të gjitha këto me kamat ligjore prej 8% duke filluar nga data 18.05.2018 – dita e ushtrimit të padisë në gjykatë e gjerë në pagesën definitive të dëmit si dhe të detyrohet e paditura që paditëses të ia paguajë shpenzimet e kësaj që në emër të shpenzimeve të

¹ Padia është ushtruar me dt.18.05.2018

² Në procesverbalin e dt.24.05.2021 me rastin e ndryshimit të kërkesëpadisë nga ana e përfaqësuesit të paditëses është konstatuar gabimisht 2 herë shuma sa i përket ndihmës dhe kujdesit të huaj edhe atë tek dëmi material shuma prej 2000€, ndërsa tek kërkesa e dëmit jo material shuma prej 1500€.

procedurës kontestimore deri në përfundim të ekzekutimit sipas tarifës të OAK-së edhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 208€, në emër të perfaqesimit në dy seanca gjyqësore shumë prej 540€, për përpilimin e ekspertizave gjyqësore shumë prej 300€, në emër të pagesës së taksës gjyqësore për padi shumë prej 41€ si dhe në emër të procedurës parakontestimore edhe atë në emër të realizimit të kërkesës për kompensimin e dëmit të ushtruar pranë të paditurës shumë prej 208€ si dhe ankesën në shumë prej 208€ të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 1505€ në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe parakontestimore nën kërcënim të përmbarimit.

Pas pranimit të padisë, kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur ia ka dërguar padinë, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje lidhur me pretendimet e saj. Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës në përgjigje në padi e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses për nga lartësia e dëmit, duke theksuar se paditësja në aksidentin e dt. 29.11.2015 ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe të njejtit janë të gatshëm që ta kompenzojnë në shumë prej 821€ për të gjitha kategoritë e dëmit kompenzues të parapara në LMD e gjithashtu ka shtuar se dokumentacioni i prezentuar shtes mjekësor nuk ka lidhje kauzale me lëndimin e datës së shënuar, diagnoza e prezentuar ka qenë e pranishme edhe në dokumentacionin fillestar dhe është sëmundje që nuk është pasojë e aksidentit.

Në seancën e shqyrtimit përgatitor kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditëses ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë dhe precizimit të bërë në seancën gjyqësore të mbajtur me dt. 12.05.2021 duke shtuar se pas administrimit të provave veç e veç dhe të gjitha së bashku është vërtetuar që paditësja V. M si rezultat i aksidentit në trafik ka pësuar lëndim të rëndë trupor dhe si pasojë po ashtu ka pësuar frikë, stres dhe traumë të intensitetit të përshkruar si në ekspertizën e ekspertëve ortoped dhe psikiatër andaj pa medysheje është vërtetuar padia dhe kërkesëpadia për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial andaj kërkojmë nga gjykata që pas administrimit të këtyre provave veç e veç dhe të gjitha së bashku të nxjerr aktgjykim me të cilin aprovohet në tërësi si e bazuar në ligj padia dhe kërkesëpadia e paditëses Vlera Matoshi për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, e gjithashtu nga gjykata ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore deri në përfundim të ekzekutimit sipas tarifës të OAK-së edhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 208€, në emër të perfaqesimit në dy seanca gjyqësore shumë prej 540€, për përpilimin e ekspertizave gjyqësore shumë prej 300€, në emër të pagesës së taksës gjyqësore për padi shumë prej 41€ si dhe në emër të procedurës parakontestimore edhe atë në emër të realizimit të kërkesës për kompensimin e dëmit të ushtruar pranë të paditurës shumë prej 208€ si dhe ankesën në shumë prej 208€ të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 1505€ në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore dhe parakontestimore.

Në seancën e shqyrtimit përgatitor për të paditurën nuk ka prezantuar askush, nga fletkthesa e dt. 11.01.2021 gjykata ka konstatuar se të njejt ftesën për seancë e kanë pranuar në mënyrë të rregullt dhe mosardhjen nuk e kanë arsyetuar, andaj konform nenit 409.2 të LPK-së shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar të mbahet me palën e paditur të pranishme. Gjithashtu në seancën kryesore të mbajtur me dt. 24.04.2021 për të paditurën nuk ka prezantuar askush në seancë, gjykata nga fletkthesa e dt.30.03.2021 ka konstatuar se të njejt ftesën për seancë kryesore e kanë pranuar në mënyrë të rregullt dhe mos ardhjen nuk e kanë arsyetuar, ashtu që me propozimin e përfaqësuesit të paditëses në një të anë e në anën tjetër gjykata duke u bazuar në nenin 423.4 të LPK-së shqyrtimin kryesorë e ka mbajtur pa pranin e të paditurës.

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: Raportin Policor me numër ... –AR- ..., të datës 29.11.2015, si dhe skicën nga vendi i ngjarjes, raportin mjekësor të QKUK-së me numër portokolli ..., raportin e Spitalit në Gjilan – EMERGJENCA me numër protokolli ... fletleshimin e QKUK-së – Klinika e Ortopedisë me traumatolgjin lokomotore me numër ...nga data 03.12.2015-15.12.2015, fletlëshimin nga Banja në Kllokot “ Nëna Naile” të dt.20.06.2016-30.06.2016, fletleshimin me numer ... të datës 03.12.2015-15.12.2015, raportin nga konsulta e Ambulancës Specialistike Ortopedia – Dr. Ceni të datës 27.02.2018, raportin nga Instituti i Radiologjis me numër ... të dt.29.11.2015, raportin nga Klinika “ALOKA” të datës 14.12.2015, raportin nga konsulta me numër ... i dt.03.12.2015, raportin nga konsulta me numër ..., raproti nga konsulta me numër ... i dt.15.12.2015, raportin nga konsutla me numër ... të dt.02.12.2015, raportin nga konsulta me numër ... të dt.14.12.2015, raportin nga konsulta me numëri dt.21.12.2015, raportin nga konsulta me numër të dt.11.12.2015, raportin nga konsulta me numër ... të dt.11.11.2015, raportin nga konsulta me numër ... të dt.14.12.2015, analizat e gjakut të bëra në Laboratorin “BIOLAB” në Gjilan të dt.04.12.2015, kuponat fiskal me numër: faturën tatimore numër ... e dt.21.06.2016 të lëshuar nga Banja e Kllokotit “Nëna Naile,, së bashku me fletleshimin prej datës ..., faturën numër ... dt.10.04.2018 të lëshuar nga “ORTOPROTECH” së bashku me kuponin fiskal numer 1, kopjen e Certifikatës së lindjes së V.M, të gjitha fotografitë e bashkangjitura në parashtrësën e dt. 25.02.2021 si dhe ekspertizat mjekësore nga ekspertët ortoped e dt. 12.03.2021 dhe psikiatër e dt. 12.03.2021.

- Sipas ekspertizës së datës 12.03.2021 nga Dr.Rrahman Hajdari ekspert i ortopedisë, e cila mbështetet në dokumentet në shkresa të lëndës, intervistës me pacienten, ekzaminimin të drejtpërdrejtë dhe raporteve specialistike rezulton se: në rastin konkret kemi të bëjmë me pasoja të lëndimeve trupore të cilat kualifikohen si lëndime të rënda trupore, me dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të lartë dy orë, të lartë (rëndë) 2 ditë, të mesëm një muaj dhe të lehtë tre muaj, zvogëlim të aktivitetit jetësor të shprehur 5% që është si pasojë lëndimit të strukturave ligamentoze- me instabilitet, me përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë në kohëzgjatje prej një muaj, ushqim të përforcuar për një muaj dhe terapi fizikale ka bërë 10 ditë.

- Sipas ekspertizës së datës 22.03.2021 nga Dr.Afrim Cana e cila mbështetet në dokumentet në shkresa të lëndës, intervistës me pacienten, ekzaminimin të drejtpërdrejtë dhe raporteve specialistike rezulton se: Nga aksidenti i pësuar paditësja V. M ka pasur frik primare të intenzitetit të lartë në një kohëzgjatje 1 minut, firk primare të intenzitetit të mesëm dhe të ulët 2 minuta, ndërsa frika sekondare është e lidhur me periudhën e rikuperimit dhe kjo frik ka qenë prezente për periudhën 6 mujore e cila ehde korespondon me raportet mjekësore.

Përfaqësuesi i paditëses ka deklaruar se nuk ka vërejtje në ekspertizat e lartëcekura dhe nuk kërkonë sqarime shtesë lidhur me asnjërën.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave te nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pjesërisht bazuar dhe ka vendsour si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate në mes të palëve ndërgjyqëse nuk janë kontestuese faktet se, më datë 18.05.2021, në Magjistralen Pejë-Prishtinë ka ndodhur aksident komunikacioni nga ngasësi i automjetit Ramadan Matoshi i cili e drejtonte veturën e pasagjerëve të markës ,, Skoda Fabia,, me targë të regjistrimit, ... të siguruar tek e paditura, në bazë të polisës së

sigurimit nr. 000...., pasi që këto fakte konfirmohen nga raporti i aksidentit nr... i dt.29.11.2015.

Sipas përgjegjjes në padi nga e paditura nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë por kontestuese ishte ishte lartësia e saj sa i përket dëmit jo material dhe dëmit material të shkaktuara ndaj paditëses V. M si pasojë e aksidentit të komunikacionit nga ngasësi i automjetit të siguruar tek e paditura.

Nga ky aksident padiësja V. M ka pësuar lëndime të rënda trupore, me çka është detyruar që të kërkoj ndihmë mjekësore nga dita e shkaktimit të aksidentit e më tutja fakte këto të cilat vërtetohen me raportin mjekësor të QKUK-së me numër portokolli ..., raportin e Spitalit në Gjilan – EMERGJENCA me numër protokolli ..., fletleshimin e QKUK-së – Klinika e Ortopedisë me traumatolgjin lokomotore me numër ... nga data 03.12.2015-15.12.2015, fletleshimin nga Banja në Kllokot “Nëna Naile” të dt.20.06.2016-30.06.2016, fletleshimin me numer ... të datës 03.12.2015-15.12.2015, raportin nga konsulta e Ambulancës Specialistike Ortopedia – Dr. Ceni të datës 27.02.2018, raportin nga Instituti i Radiologjis me numër.... të dt.29.11.2015, raportin nga Klinika “ALOKA” të datës 14.12.2015, raportin nga konsulta me numër... i dt.03.12.2015, raportin nga konsulta me numër ..., raporti nga konsulta me numër ... i dt.15.12.2015, raportin nga konsulta me numër ... të dt.02.12.2015, raportin nga konsulta me numër ... të dt.14.12.2015, raportin nga konsulta me numër ... i dt.21.12.2015, raportin nga konsulta me numër ... të dt.11.12.2015, raportin nga konsulta me numër ... të dt.11.11.2015, raportin nga konsulta me numër ... të dt.14.12.2015, analizat e gjakut të bëra në Laboratorin “BIOLAB” në Gjilan të dt.04.12.2015, kuponat fiskal me numër: ...faturën tatimore numër 0.... e dt.21.06.2016 të lëshuar nga Banja e Kllokotit “Nëna Naile,, së bashku me fletleshimin prej datës 20.06.2016-30.06.2016, faturën numër ... dt.10.04.2018 të lëshuar nga “ORTOPROTECH” së bashku me kuponin fiskal numer 1. Gjithashtu lëndimet e pësuar të paditëses vërtetohen edhe nga ekspertizat mjekësore nga eksperti ortoped Dr. Rrahman Hajdari e datës 12.03.2021, ekspertiza nga eksperti psikiatër Dr. Afrim Cana e datës 22.03.2021, ku u vërtetua se paditësja V. M, ka pasur lëndime të cilat kualifikohen si lëndime të rënda trupore, me dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të lartë dy orë, të lartë (rëndë) 2 ditë, të mesëm një muaj dhe të lehtë tre muaj, zvogëlim të aktivitetit jetësor të shprehur 5% që është si pasojë lëndimit të strukturave ligamentoze- me instabilitet, me përkujdesje dhe ndihmë të personit të tretë në kohëzgjatje prej një muaj, ushqim të përforcuar për një muaj dhe terapi fizikale ka bërë 10 ditë, si dhe nga aksidenti i pësuar paditësja V. M ka pasur frik primare të intenzitetit të lartë në një kohëzgjatje 1 minut, firk primare të intenzitetit të mesëm dhe të ulët 2 minuta, ndërsa frika sekondare është e lidhur me periudhën e rikuperimit dhe kjo frik ka qenë prezente për periudhën 6 mujore e cila ehde korespondon me raportet mjekësore.

Andaj, gjykata nga të gjitha faktet e cekura më lartë, të cilave në tërësi ua fali besimin pasi që ishin në përputhshmëri të drejtpërdrejt njëra me tjetrën dhe të lëshuara nga institucionet përkatëse kompetente pa mëdyshje është konstatuar fakti se përgjegjësia për shkaktimin e aksidentit ka qenë e të siguruarit të të paditurës dhe se bazuar në këtë del përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit e parashikuar në bazë të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (nr.04/L-018), në lidhje me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), për shkak të aksidentit të ndodhur me dt.29.11.2015.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi në bazë të lartëcekurave ku ka vërtetuar se e paditura, përkatësisht i siguruari i saj është përgjegjës ndaj këtu paditëses konform përgjegjësisë në bazë të fajësisë, të paraparë në nenin 136 par.1 të Ligjit mbi

Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cili parasheh se „ **Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij,**„ dhe dispozitave mbi kompensimin e dëmit konform shkallës së përgjegjësive të tyre për dëmin material të shkaktuar, e të parapara në nenin 173 par.2 të LMD-së ku parashihet se „ **Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashihet diçka tjetër,**„ si dhe dëmit jo-material konform nenit 183.1 dhe 2 të LMD-së i cili parasheh se „**Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyejnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.** 2. **Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror,**„ lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK). Në lidhje me kërkesat e aprovuara në shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata është e mendimit se të njëjtat janë adekuate, duke marrë parasysh dëmin që i është shkaktuar paditëses dhe moshën e saj të re dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësojë të dëmtuarës – këtu paditëses, satisfaksion, që ajo të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompenzojë të mirat jomateriale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ajo do ta kishte poqëse të njëjtat nuk do t'i kishte humbur, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e nevojshme të shërimit, pasojat e lëndimeve më afër të përshkruara si në mendimet e ekspertëve të lartcekur, dhe mbi të gjitha deformimin e shtyllës kurrizore dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 5 %, respektivisht pasojat e lëndimeve të përshkruara si në mendimet e ekspertëve të lartcekur, fakti i shëmtimit mund të shihet edhe në fotografit të cilat i janë bahskangjitur shkresave të lëndës ku shihet se paditësja ka ndërhyrje kirurgjike në fytyrë në anën e majtë afër veshit. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash, gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe faktin që me të njëjtin, të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e këtij kompensimi dhe qëllimin e tij shoqëror. Po ashtu, me rastin e aprovimit të kërkespadiës së paditëses sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata mori për bazë edhe faktin si në përgjegjëje në padi ku e paditura kishte deklaruar se e konteston kërkesëpadinë pjesërisht për nga lartësia, me ç'rast për kompensimin e të gjitha llojeve të dëmit të shkaktuar ndaj paditëses, ai kishte ofruar shumën prej 821 €, por për të cilën shumë nuk ishte dakorduar paditësja.

Gjykata pjesën tjetër të kërkespadiës së paditëses si në dispozitivin e **II** të këtij aktgjykimi sa i përket dëmit jo material në lartësi prej 7000 € të kërkuar më shumë se shumat e gjykuara i refuzoi si të pabazuara duke marrur parasysh edhe praktikën gjyqësore në caktimin e lartësisë së detyrimeve për rastet e njëjta dhe e cila është shumë e lartë dhe nuk përkon me interesin dhe rëndësinë-qëllimit të shkeljes së të mirës së paditëses dhe duke marrë parasysh nenin 183 par.2 i LMD-së ku parashihet se „ **Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror...**

Gjykata ka vendosur si në dispozitivin e **III** të këtij aktgjykimi ku e ka aprovuar kërkespadinë e paditëses sa i përket dëmit material edhe atë për shpenzimet e mjekimit shumën në lartësi prej 40.10€ pasi që paditësja gjykatës i ka ofruar provat me të cilat e ka vërtetuar lartësinë e këtyre shpenzimeve të mjekimit si dëftesë pagesat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, për përkujdesjen e personit të tretë dhe për ushqimin e përforcuar shumën në lartësi prej 600€, për shak se ndihmën e nevojshme dhe ushqimin e përforcuar paditësja e ka marrë nga familja e saj për çka nuk mund të ofrojë provë materiale, por shpenzimet e tilla për këto dy kategori të dëmit i kanë konstatuar ekspertët mjekësor si dhe shuma e aprovuar konisedrojmë se është brenda limiteve të pranuar nga praktika gjyqësore.

Gjykata e ka refuzuar kërkespadinë e paditëses si në dispozitivin e **IV** të këtij aktgjykimi përtej shumave të gjykuara sa i përket përkujdesjes dhe ndihmës nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar shumën prej 3400€, edhe atë 1700€ për përkujdesje nga personi i tretë dhe 1700€ për ushqim të përforcuar pasi që shuma e kërkuar (2000€ + 2000€) për këto kategori të dëmit material është jashtë limiteve të pranuar nga praktika gjyqësore si dhe e ka refuzuar shumën në lartësi prej 464.42€ në emër të shpenzimeve të mjekimit pasi që të njëjtën shumë paditësja, përkatësisht përfaqësuesi i saj me autorizim si në shkresat e lëndës nuk i ka kërkuar, por i njëjti për këtë kategori të dëmit i ka kërkuar vetëm 40.10€ në emër të shpenzimeve mjekësore.

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëses, bazës juridike të padisë dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat materiale të LIGJI-të NR. 04/L-077 LMD meqë raporti juridiko civil është krijuar në kohën sa ka qenë ne fuqi ky ligj, ndërsa procedura kontestimore u zhvillua në pajtim me rregullat e procedurës kontestimore, sipas dispozitave ne fuqi, ndërsa baza e përgjegjësisë së të paditurës rrjedhë nga dispozitat ligjore të LMD edhe atë nenit 136.1 dhe 173.2 lidhur me nenet 183.1 dhe 2 të LMD si dhe neneve 9 dhe 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia.

Gjykata vendosi që e paditura është e detyruar që paditëses t'ia kompensoj dëmin jomaterial me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, respektivisht nga data 24.05.2021 e deri në pagesën definitive, ndërsa për dëmin material me kamatë bankare ashtu siç paguajnë bankat komerciale në Kosovë për mjetet e deponuara pa destinim të veçantë, që nga data 29.11.2015 si ditë e shkaktimit të dëmit, kurse pas kësaj date me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke llogaritur nga data e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, konform nenit 382 parag. 2 të LMD.

Gjykata ka vendosur si në pikën **V** të dispozitivit të këtij aktgjykimi që e paditura, paditëses t'ia paguaj shpenzimet gjyqësore konform nenit 452 dhe 453 të LPK, meqë paditësja në pjesën më të madhe të kërkesëpadisë ka patur sukses, prandaj e detyroi të paditurën që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet gjyqësore për përpilimin e padisë 104€, për taksë gjyqësore për padi 41 €, për ekspertizën mjekësore të mjekut ortoped shumën 150.00€, për ekspertizën mjekësore të mjekut psikiatër shumën 150.00 euro, për përfaqësim për dy seanca gjyqësore 2x135.20€, shumën në lartësi prej 270.40€, në total shumën në lartësi prej 715.40€ e në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, ndërsa duke marrur parasysh vlerën e kontestit shumën e kërkuar në lartësi prej 909€ më shumë se shumat e gjykuara në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore e ka refuzuar si të pa bazuar e gjithashtu edhe shumën në lartësi prej 416€ në emër të procedurës parakontestimore e ka refuzuar si të pa bazuar pasi që e njëjta ka të bëjë me procedurë administrative e jo me procedurë gjyqësore,

Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh edhe provat tjera materiale, por ato ishin i relevante në vendosjen meritore të kësaj çështje, ashtu që nuk u arsyetuan veç e veç. Nga arsyet e cekura më lartë e bazuar edhe në nenit 143 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 485/18, dt.24.05.2021

Gjyqtarja,
Kaltrinë HALITI

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimi të vendimit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.